

Nr. 8805 Prot.

Tiranë, më 10/12 2021

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI**
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë

Për dijeni: **Z. Adrian ÇELA**
Administrator
“Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group” SH.A.

Lënda: **Mbi disa komente dhe propozime për “Rregulloren për masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”**

I nderuar Z. Ahmeti,

Në kuadër të procedurave për hartimin e “Rregullores për masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit” pranë Furnizuesit të Shërbimit Universal SH.A. është kërkuar mendim lidhur me përmbajtjen e draft rregullores.

Pas njohjes me dokumentin, si dhe konsultimit me strukturat e “OSHEE GROUP” SH.A., më poshtë gjëni disa propozime të shoqërisë “FSHU” SH.A. lidhur me përmbajtjen e “Rregullores për masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”:

Në paragrafin hyrës :

Sugjerojmë të hiqet fjala "urdhrave" për tu vënë theksi tek veprimtaria kryesore, vendimet e organit kolegjal të ERE-s, në referim edhe të terminologjisë së ligjit "Për Sektorin e Energjisë Elektrike, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore.

Në nenin 3 pika 4 :

Sugjerojmë që fjala "zgjidhje" të zëvendësohet me "trajtim" pasi jo gjithmonë zgjidhja e problematikës mund të realizohet nga ana e Furnizuesit, si dhe jo gjithmonë kërkesat e klientëve gjejnë mbështetje në legjislacionin e sektorit të energjisë.

Në nenin 4 :

Sugjerojmë që parashikimet e këtij neni mbi monitorimin dhe raportimin duhet të reflektohen edhe në Vendimin nr. 217, datë 15.12.2020 “Mbi Rishikimin e planit të masave për OSHEE për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 201, datë 03.09.2018.

Nga krahasimi i dy dokumentave konstatojmë se kemi të bëjmë me të njëjtat parashikime por me afate të ndryshme, konkretisht në Vendimin nr. 217, date 15.12.2020 “Mbi Rishikimin e planit të masave për OSHEE për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 201, datë 03.09.2018, në pikën 15 c) dhe d), “Monitorimi dhe Raportimi”, është bërë i njëjti parashikim në lidhje me zhvillimin e anketave të Shërbimit të klientit, por ka një ndryshim të afateve brenda së cilës duhen kryer ky anketim ose raportuar ne ERE rezultatet e këtyre anketave.

Po kështu sipas draftit të propozuar përcaktohet se “...furnizuesi brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje do të hartojë nje plan veprimi të ri”, duke mos u përcaktuar nëse ky plan veprimi duhet miratuar nga ERE apo jo.

Ndërkohe që në Planin e masave të rishikuar, përcaktohet se ky plan i ri veprimi hartohet brenda 12 muajve pas mbledhjes dhe analizimit të rezultateve të anketimit, si dhe duhet të miratohet nga ERE.

Në këto kushte, duke qenë se të dyja këto vendime kanë ndryshime, mendojmë se ndryshimet e propozuara në draftin e “Rregullores mbi masat e të licensuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”, duhet të reflektohen edhe në Vendimin nr.217, date 15.12.2020 “Mbi Rishikimin e planit të masave për OSHEE për respektimin e të drejtave të klienteve të furnizimit me energji elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit te ERE Nr. 201, datë 03.09.2018, për pjesët respektive.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj dhe në marrjen parasysh të propozimeve të shoqërisë “FSHU” SH.A..

Me respekt,

Elton SEVRANI
Administrator

FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A.